



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE**

**VENDIM**

**Nr. 746, datë 20.11.2019**

**PËR**

**DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 294, DATË 8.4.2015 TË KËSHILLIT TË  
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KËSHILLIT TË INVESTIMEVE”, TË  
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të marrëveshjes ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Evropiane për Rindërtimin dhe Zhvillim, për bashkëpunimin në mbështetje të klimës së investimeve dhe qeverisjes së mirë, nënshkruar në 24 shkurt 2014, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Diasporën, Këshilli i Ministrave

**VENDOSI:**

Në vendimin nr. 294, datë 8.4.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar bëhen këto ndryshime:

1. Nëndarja “i”, e shkronjës “a”, të pikës5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“i. institucione shtetërore, 4 anëtarë:

- ministri i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
- Banka e Shqipërisë;
- Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve;
- Fondi Shqiptar Për Zhvillimin e Diasporës.



2. Nëndarja “iii”, e shkronjës “a”, të pikës 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“iii. Dhoma të Tregtisë dhe Industrisë, 3 anëtarë:

- Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë;
- Dhoma e Biznesit të Diasporës.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**KRYEMINISTRI**

**EDI RAMA**

**Në mungesë dhe me porosi**

**ZËVENDËSKRYEMINISTRI**

**ERION BRAÇE**

**MINISTRI I SHTETIT  
PËR DIASPORËN**

**PANDELI MAJKO**